Komuna e Zhelinës

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal e Komunës së Zhelinës 2016-2020

Kjo strategji për zhvillim ekonomik lokal e Komunës së Zhelinës për periudhën 2016-2020 është përgatitur nga ana e shtëpisë për konsulencë SEG Holding – www.seg-holding.com.

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL E KOMUNËS SË ZHELINËS 2016-2020

shtator 2015

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave 5
1. Rezyme 6
2. Procesi i planifikimit strategjik 7
3. Analiza e gjendjeve në Komunën e Zhelinës 8
3.1 Informata të përgjithshme për Komunën e Zhelinës 8
3.2 Popullata 9
3.3 Subjektet afariste dhe punësimi 11
3.4 Infrastruktura rrugore dhe banesat e përfunduara 15
3.5 Bujqësia 16
3.6 Arsimi 2
3.7 Papunësia 2
Përfundim: 3
4. Analiza e rezultateve nga hulumtimi në terren në Komunën e Zhelinës 4
5. Vizioni, misioni dhe përparësitë e Komunës së Zhelinës 6
5.1 Vizioni 6
5.2 Misioni 6
5.3 Vlerat 6
5.4. Prioritetet për zhvillim të Komunës së Zhelinës 6
6. Qasja strategjike e Komunës së Zhelinës 7
6.1 Qëllimet strategjike 7
6.1.1 Qëllimi strategjik 1: Zhvillimi i infrastrukturës në komunë 8
6.1.2 Qëllimi specifik 2: Zhvillimi socio-ekonomik i popullatës 9
6.1.3 Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi i shkathtësive njerëzore 12
6.1.4 Qëllimi strategjik 4: Zhvillimi i efikasitetit energjetik 13
Shtojca 1. PLANI AKSIONAR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË 0
Shtojca 2. EKIPI PËR PËRGATITJEN E STRATEGJISË SË KOMUNËS SË ZHELINËS 0

Lista e shkurtesave

APRM	Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë
PA	Plane aksionare
BPV	Bruto prodhimi i vendit
ESHS	Enti Shtetëror për Statistikë
PDU	Plani detajor urbanistik
BE	Bashkimi Evropian
NJVL	Njësia e vetëqeverisjes lokale
NP	Ndërmarrje publike
PPP	Partneritet publik privat
SHQ	Shoqatë e qytetarëve
PAL	Plane aksionare lokale
DZHEL	Departamenti për zhvillim ekonomik lokal
KESL	Këshilli ekonomiko-social lokal
VL	Vetëqeverisje lokale
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
RQM	Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë
QPS	Qendra për punë sociale
QRPP	Qendra e rajonit planor e Pollogut

1. Rezyme

Komuna e Zhelinës është komunë e cila funksionon pavarësisht që nga 1996. Komuna ka rreth 27.000 banorë në 18 vendbanime, prej të cilave mbi 99% janë shqiptarë. Komuna nga Tetova është larg 8 km dhe nga Shkupi 35 km dhe në atë kalon transit autostrada e cila e lidh Qytetin e Shkupit dhe Tetovën. Komuna gjendet në anën e djathtë të lumit Vardar, në shpatin e Malit të Thatë dhe përfshinë një pjesë të liqenit artificial Kozjak.

Në komunë në vitin 2013 ka pasur 282 ndërmarrje, prej të cilave 208 ndërmarrje mikro, 71 të vogla, 2 të mesme dhe 1 ndërmarrje e madhe. Më së shumti kompani dhe të punësuar në sektorin privat ka në ndërtimtari, transport dhe depo, industrinë përpunuese dhe në objekte për vendosje dhe veprimtaritë shërbyese me ushqim.

Analiza e situatës tregon se edhe krahas avancimit të bërë në një pjesë të fushave për zhvillim të komunës, ekzistojnë akoma mundësi dhe sfida të mëdha në shumë fusha, siç janë: infrastruktura, sipërmarrësia dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla, biznes rrethimin dhe krijimin e vendeve të punës, zhvillimi i bujqësisë, hoteleria dhe turizmi.

Vizioni i Komunës së Zhelinës është të rritet në qendër të rëndësishme ekonomike përmes bashkëpunimit të fuqishëm me punëdhënësit, të cilët do t'i rritin investimet dhe do të krijojnë vende të punës. Për realizimin e vizionit, Komuna do të rritet në servis efikas të qytetarëve dhe bizneseve në komunë.

Duke i pasur parasysh analizat dhe diskutimet e realizuara, qëllimet relevante strategjike të cilat paraqesin bazë për zhvillim ekonomik lokal janë infrastruktura, zhvillimi socio-ekonomik dhe zhvillimi i shkathtësive njerëzore.

Qëllimet strategjike do të realizohen me aktivitete relevante nga ana e njësisë së vetëqeverisjes lokale, punëdhënësve dhe shkollave, dhe të njëjtat do të kontribuojnë deri te zhvillimi i Komunës së Zhelinës.

Si pjesë relevante e Strategjisë është forcimi i kapaciteteve dhe strukturave të komunës për vendosjen e sistemit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal. Vendosja e marrëdhënieve solide të punës dhe strukturës organizative për mbështetje të procesit do të kontribuoje për partneritet të dobishëm mes sektorit publik, privat dhe joqeveritar.

2. Procesi i planifikimit strategjik

Procesi i planifikimit strategjik të zhvillimit lokal ka pesë faza. Fazat në praktikë janë procese fleksible, kur një fazë përputhet me tjetrën varësisht nga nevojat lokale. Kjo strategji është dokument "i gjallë", që duhet të ndryshojë siç e diktojnë rrethanat.

Faza e parë është **organizimi i procesit.** Gjatë përgatitjes së Strategjisë në fazën e hershme u arrit marrëveshja për mbështetje institucionale dhe mbështetja nga palët tjera të prekura. U identifikuan personat, institucionet dhe bizneset dhe aktorët tjerë, të cilët kanë ndikim mbi zhvillimin ekonomik. Po ashtu, u formua ekipi për menaxhim me procesin, i cili u koordinua nga DZHEL. Ekipi ishte i përbërë nga persona të sektorit publik, privat dhe joqeveritar.

Faza e dytë është **analiza e gjendjeve në komunë,** me të cilën u identifikua e kaluara dhe u parashikuan trendët. Analiza e gjendjeve në komunë i mundësoi bashkësisë t'i determinojë elementet kritike të ekonomisë lokale dhe t'i identifikojë qëllimet dhe aktivitetet/projektet adekuate, si dhe institucionet dhe partnerët e përshtatshëm.

Faza e tretë është **përpunimi i Strategjisë**. Në planifikimin strategjik gjithëpërfshirës qëllimi ishte të bëhet qasje e integruar në përpunimin e Strategjisë, Në zhvillimin e Strategjisë pjesëmarrësit nga NJVL u inkurajuan të bëjnë qasje të balancuar mes nevojave ekonomike dhe shoqërore. Komponentët kryesor të Strategjisë dhe plani aksionar janë vizioni, qëllimet strategjike dhe aktivitetet. Vizioni e përshkruan ardhmërinë ekonomike të bashkësisë dhe jep drejtime të qarta të veprimit deri në vitin 2020. Qëllimet strategjike dalin nga analiza e gjendjeve dhe i pasqyron fushat të cilat janë prioritare. Aktivitetet e paraqesin bërthamën e strategjisë dhe të njëjtat janë reale për nga vëllimi dhe në drejtim të nevojave dhe mundësive të bashkësisë lokale.

Faza e katërt është **implementimi i Strategjisë** për të cilën u zhvilluan plani aksionar duke përfshirë rezultatet dhe burimin e verifikimit të tyre, institucionet përgjegjëse për implementim, kornizën kohore dhe buxhetin (pa buxhet administrativ). Si pjesë e planit aksionar është edhe forcimi i kapaciteteve për monitorim dhe revizion të planit aksionar nga ana e DZHEL.


Faza e pestë dhe e fundit **është rishqyrtimi/revizioni i Strategjisë dhe plani aksionar.** Zhvillimi i sistemit për monitorim dhe evaluim do të jetë bazë për revizionin e parë në vitin 2017. I njëjti do të ketë për qëllim t'i mundësojë ekipit lokal që më mirë t'i shqyrtojë rezultatet, t'i arsyetojë shpenzimet, të bëjnë përmirësime ose përshtatje, dhe të zhvillohen praktikat e mira.

3. Analiza e gjendjeve në Komunën e Zhelinës

3.1 Informata të përgjithshme për Komunën e Zhelinës


Komuna e Zhelinës gjendet në rajonin e Pollogut dhe shtrihet në sipërfaqe prej 201 m2, që paraqet 8,3% të rajonit të Pollogut. Në komunë në vitin 2013 është vlerësuar se jetojnë 27.329 banorë, prej të cilëve 4.110 jetojnë në vendbanimin Zhelinë. Numri i përgjithshëm i amvisërive është 5.226, që do të thotë nga 5.2 banorë në amvisëri, që është dukshëm m shumë se mesatarja nacionale, që mesatarisht është 3.6 persona. Lidhur me përkatësinë etnike 99.2% janë shqiptarë, në pajtim me regjistrimin prej vitit 2002.

Fotografia nr. 1. Pozita e Komunës së Zhelinës



Regjioni i Komunës së Zhelinës, që paraqet mjedis rural, ka 18 vendbanime: Zhelinë, Debarcë, Strimnicë, Larçe, Sedllarevë, Kopaçin Doll, Merovë, Çiflik, Novo Sellë, Grupçin, Roglë, Leshnicë e Poshtme, Leshnicë e Epërme, Llukovicë, Ozormishtë, Pallaticë, Trebosh dhe Cerovë. Komuna kufizohet me Tetovën, Qytetin e Shkupit – Sarajin, Bërvenicën, Jegunovcin, Makedonski Brodin dhe Sopishtin. Nëpër komunë kalon autostrada që e lidh Qytetin e Shkupit dhe Tetovën, ndërsa larg Tetovës është 8 km dhe prej Shkupit 35 km. Komuna gjendet në anën e djathtë të lumit Vardar, në shpatin e Malit të Thatë dhe përfshinë një pjesë të liqenit artificial Kozjak.

Fotografia nr. 2. Vendbanimet në Komunën e Zhelinës



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

3.2 Popullata

Në periudhën prej vitit 2000 deri më 2013 numri i banorëve është rritur prej 24.371 në 27.958 persona ose mesatarisht nga 228 banorë në vjet. Rritje më të madhe ka te grup mosha prej 40-49 vjet dhe atë për 1.741 persona, dhe te grup mosha prej 50-59 vjet për 1.063 persona. Në periudhën e raportimit ulje më të madhe ka te personat e moshës prej 0-9 vjet dhe atë për 1.318 persona dhe te grup mosha 10-19 vjet për 160 persona.

Tabela nr. 1. Popullata në Zhelinë sipas grup moshave prej vitit 2000 deri më 2013


Viti	Gjithsej	0-9	10-19	20-29	30-39	40-49	50-59	60-69	70+	të panj.
2000	24,371	5,161	5,021	4,718	3,695	2,141	1,419	1,241	859	116
2001	24,740	5,073	5,065	4,770	3,837	2,278	1,457	1,237	910	113

2002	24,407	5,016	5,017	4,433	3,826	2,442	1,559	1,248	813	53
2003	24,721	4,873	5,085	4,487	3,926	2,582	1,596	1,253	872	47
2004	25,013	4,711	5,163	4,555	3,978	2,737	1,659	1,246	921	43
2005	25,305	4,568	5,220	4,616	4,051	2,878	1,715	1,257	961	39
2006	25,595	4,444	5,247	4,681	4,128	3,002	1,806	1,261	990	36
2007	25,885	4,348	5,258	4,747	4,186	3,149	1,870	1,265	1,028	34
2008	26,146	4,224	5,256	4,822	4,237	3,306	1,904	1,313	1,053	31
2009	26,428	4,128	5,229	4,895	4,285	3,453	1,993	1,325	1,091	29
2010	26,697	4,047	5,181	4,935	4,379	3,563	2,096	1,335	1,135	26
2011	26,915	3,942	5,117	4,967	4,466	3,660	2,227	1,368	1,142	26
2012	27,118	3,864	5,012	5,013	4,518	3,787	2,351	1,405	1,143	25
2013	27,329	3,843	4,861	5,077	4,565	3,882	2,482	1,444	1,151	24
Ndryshimi 2000-2013	2,958	-1,318	-160	359	870	1,741	1,063	203	292	-92

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Lidhur me strukturën e popullatës sipas grup moshave në grafikun numër 1 mund të vërehet se pjesëmarrja e personave të moshës prej 40 vjet deri 59 vjet rritet për 15% në vitin 2000 në 23% në vitin 2013 si përqindje prej popullatës së përgjithshme, lidhur me grup moshën prej 0 deri 19 vjet, ku zvogëlohet prej 42% në vitin 2000 në 32% në vitin 2013. Duke e pasur parasysh të lartpërmendurën mund të vërehet se në komunë ka **filluar procesi plakjes së butë** në strukturën e saj të popullatës. Po ashtu, duhet të merret parasysh se pjesëmarrja e **popullatës së re deri në 15 vjet është afër 22% që është dukshëm më shumë se mesatarja nacionale ku është rreth 17%.**

Grafiku nr. 1. Struktura e popullatës sipas grup moshës prej vitit 2000 deri 2013



Burim: Llogaritjet e autorit në bazë të dhënave prej ESHS

Në komunë në periudhën prej vitit 2005 deri 2013 mesatarisht ka 388 foshnja të lindura. Në vitin 2006 dhe 2009 vërehet numri më i madh i foshnjave të lindura dhe atë 414 dhe 408 foshnja, ndërsa numri më i vogël vërehet në vitin 2010 dhe 2011, kur kanë lindur 368 dhe 364 foshnja. Duke pasur parasysh se në vitin 2013 ka 384 foshnja të lindura, që është më afër mesatares prej 388 foshnja në vjet, mund të thuhet se **nataliteti prej 2005 deri në 2013 është në nivel konstant.** Lidhur me moshën e nënave mund të vërehet se 37% të foshnjave të lindura janë të nënave të moshës prej 25 vjet deri 29 vjet. Po ashtu, **nuk ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e të gjitha grup moshave prej viti 2005 deri 2013.**

Tabela nr. 2: Foshnjat e lindura sipas moshës së nënave dhe martesave të lidhura sipas viteve

Viti	Gjithsej	nën 15 vjet	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 +	Martesa të lidhura
2005	387	0	12	108	153	95	16	3	0	0	282
2006	414	0	19	95	170	96	30	3	0	1	287
2007	393	0	23	110	153	78	26	3	0	0	356
2008	380	0	15	108	148	74	30	5	0	0	293
2009	408	0	19	124	150	88	26	1	0	0	305
2010	368	0	13	109	138	85	18	5	0	0	259
2011	364	0	20	97	137	73	34	2	1	0	272
2012	392	0	20	119	136	86	26	5	0	0	251
2013	384	0	18	102	143	86	27	8	0	0	254
Mesatarja 2005-2013	388	0	18	108	148	85	26	4	0	0	284

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Lidhur me martesat e lidhura në komunë prej vitit 2005 deri 2013 mesatarisht janë lidhur 284 martesa. Numri më i madh i martesave janë lidhur në vitin 2007 dhe atë 365 martesa, ndërsa më pak në vitin 2012 dhe 2013 kur ka pasur 251 d.m.th. 254 martesa të lidhura. Duke pasur parasysh **uljen e butë të martesave të lidhura në vitin 2012 dhe 2013 ekzistojnë rreziqe për zvogëlimin e foshnjave të lindura në periudhën afatmesme,** para së gjithash sepse në periudhën prej viti 2005 deri 2009 janë lidhur mesatarisht nga 306 martesa, ndërsa në periudhën prej vitit 2010 deri 2013 nga 259 martesa mesatarisht në vjet.

3.3 Subjektet afariste dhe punësimi

Në vitin 2013 në komunë ka pasur **282 ndërmarrje prej të cilave 208 makro ndërmarrje, 71 të vogla, 2 të mesme dhe 1 ndërmarrje e madhe.** Në raport me vitin 2009 ka pasur rritje të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve, e cila para së gjithash ka të bëjë me rritjen e numrit të ndërmarrjeve mikro. Po ashtu, është e rëndësishme të përmendet se për herë të parë në vitin 2013 ka edhe **ndërmarrje e madhe e cila ka më shumë se 250 të punësuar.** Nga struktura e ndërmarrjeve mund të shuhet se 99% janë ndërmarrje mikro dhe të vogla.


Tabela nr. 3: Subjekte aktive afariste sipas madhësisë, sipas komunave, sipas viteve, gjendja më 31 dhjetor

Viti / Madhësia	2009	2010	2011	2012	2013	Ndryshimi 2009-2013
Gjithsej	262	293	294	301	282	20
Mikro	149	160	183	222	208	59
Të vogla	111	131	109	76	71	-40
Të mesme	2	2	2	3	2	0
Të mëdha	0	0	0	0	1	1

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Prej grafikut mund të shihet se numri më i madh i ndërmarrjeve aktive janë në shërbimet tregtare, të cilat janë 51% prej ndërmarrjeve aktive, pas çka vijon ndërtimtaria me 20% dhe industria me 16%. Numër më të madh të ndërmarrjeve aktive ka në bujqësi, por e dhuna duhet të merret me kujdes duke pasur parasysh sipërfaqen e disponueshme bujqësore në komunë dhe mundësia për një pjesë të personave të mos jenë formalisht të punësuar në këtë sektor.

Grafiku nr. 2. Struktura e ndërmarrjeve sipas sektorëve[1] për vitin 2013



Burimi: Llogaritja e autorit në bazë të dhënave prej ESHS

Në vitin 2014 në komunë kanë qenë të regjistruara 241 subjekte afariste, që kanë realizuar të ardhura dhe së paku një të punësuar, ku ka 1.048 të punësuar prej të cilave 464 persona në ndërmarrjet mikro. **Ndërmarrjet nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm që ta pranojnë ofertën e fuqisë punëtore.** Në 18 subjektet afariste me dhjetë ose më shumë të punësuar të cilat janë regjistruar në komunë kanë 548 të punësuar. Duke pasur parasysh

[1] Vlera e vlerësuar për shërbimet tregtare dhe shërbimet jo tregtare

numrin e popullatës dhe numrin e kërkuesve aktiv për punë në Agjencinë për punësim në RM nga komuna, mund të përfundohet se **numri i vendeve formale të punës është shumë i vogël dhe krijimi i vendeve të punës do të duhej të paraqesë një nga prioritetet e pushtetit lokal.**

Tabela nr. 4: Subjekte afariste të cilat realizojnë të ardhura dhe kanë të paktën një të punësuar për vitin 2014

Madhësia e ndërmarrjes	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve në ndërmarrje
1-9 të punësuar	223	464
10-19 të punësuar	10	137
20-49 të punësuar	5	166
50+ të punësuar	3	281
Gjithsej të punësuar	241	1,048

Burimi: Regjistri Qendror i RM

Në vitin 2013 numri më i madh i ndërmarrjeve gjenden në Tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë; ndreqja e automjeteve dhe motoçikletave me 84 ndërmarrje, por edhe në sektorin e njëjtë ka zvogëlim të madh në raport me vitin 209 kur ka pasur 95 ndërmarrje. Në Ndërtimtari ka 57 ndërmarrje, në Transport dhe deponim 44 ndërmarrje, në Industrinë ushqimore 40 ndërmarrje dhe në Objekte për vendosje dhe veprimtaritë shërbyese me ushqim 12 ndërmarrje. **Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve aktive janë në këto katër sektorë që mund të paraqesë bazë për zhvillimin e qasjeve sektoriale në aktivitetet zhvillimore.**

Tabela nr. 5. Subjektet aktive afariste sipas sektorëve të veprimtarisë sipas KNV Rev.2, sipas viteve

Viti	2010	2011	2012	2013	Ndryshimi 2010-2013
Gjithsej	293	294	301	282	-11
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria	11	16	18	12	1
Xehetaria dhe nxjerrja e gurit	4	4	3	1	-3
Industria përpunuese	35	36	36	40	5
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim	1		1		-1
Furnizimi me ujë: mënjanimi i ujërave të zeza, menaxhimi me mbeturinat: sanimi i ambientit	4	3	4	4	0
Ndërtimtaria	54	62	64	57	3
Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë; ndreqja e automjeteve dhe motoçikletave	95	93	92	84	-11
Transport dhe deponim	44	41	44	44	0

Objektet për vendosje dhe veprimtaritë shërbyese me ushqim	17	14	12	12	-5
Informata dhe komunikime			1		0
Veprimtari financiare dhe veprimtari të sigurimit	2	2	2	2	0
Veprimtari lidhur me pronën e patundshme	1	1			-1
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	3	1	2	3	0
Veprimtari administrative dhe ndihmëse shërbyese	3	3	3	4	1
Drejtoria publike dhe mbrojtja: sigurimi i domosdoshëm social	1		1	1	0
Arsimi	5	5	5	5	0
Veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	8	9	9	10	2
Art, zbavitje dhe rekreacion	2	2	2	1	-1

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Në komunë ka 12 subjekte afariste në pronësi private me më shumë se 10 të punësuar. Prej tyre 6 në vendbanimin Zhelinë, 2 në Strimnicë, 2 në Trebosh dhe nga një në Novo Sellë dhe Ozormishtë. Punëdhënësi më i madh është Vezë Sharri, që paraqet fermë për prodhimin e vezëve dhe fabrikë për prodhimin e mishit të puls dhe viçit. Në drejtim të përmirësimit të gjendjes në komunë **përmes zhvillimit të biznes rrethimit, bashkëpunimi me punëdhënësit do të mund të paraqiste një nga qëllimet e ardhshme.**

Tabela nr. 6. Subjektet afariste në pronësi private të regjistruara në komunë me më shumës e 10 të punësuar sipas veprimtarive dhe numrit të punësuarve për vitin 2014

Veprimtaria	Emri i subjektit	Vendi	Numri i të punësuarve
Nxjerrja e çakallit dhe rërës; argjilit dhe kaolinit	GOLEC TRANS	ZHELINË	20
Prodhimi i mishit të shtazëve dhe shpezëve	LECKER	TREBOSH	27
Kultivimi i shpezëve	VEZË SHARRI	TREBOSH	47
Prodhimi i prodhimeve tera prej betoni, gjipsi dhe çimentoje	FATI TRANS-AG	ZHELINË	15
Prodhimi i prodhimeve tjera prej betoni, gjipsi dhe çimentoje	BESHA-TRANS	ZHELINË	11
Ndërtimi i banesave dhe ndërtesave jo për banim	MAT-BAU	STRIMNICË	11
Transporti ngarkues rrugor	HILDIN TRANS	ZHELINË	17
Tregtia me shumicë me dru, material ndërtimor dhe pajisje sanitare	HILDIN KOMERC	ZHELINË	10

Tregtia me shumicë me mbeturina dhe mbetje	AID-ASKO KOMERC	NOVO SELLË	12
Tregtia me pakicë me mall prej metali, ngjyra dhe qelq në prodh. të specializuara	LIBERTAKOM	STRIMINICË	10
Tregtia me pakicë me mall prej metali, ngjyra dhe qelq në prodh. të specializuara	ELEGANT KOMPANI	OZORMISHTË	15
Veprimtari të praktikës së përgjithshme medicinale	FLOERNS	ZHELINË	19

Burimi: Regjistri Qendror i RM

3.4 Infrastruktura rrugore dhe banesat e përfunduara

Infrastruktura rrugore si bazë për zhvillimin e komunës shënon përmirësim të vazhdueshëm edhe në vitin 2014, ku arrin 147 km që paraqitet rritje për 53 km në raport me vitin 2006. Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor lokal të sapondërtuar është asfalt dhe gurë katror në gjatësi prej 34 km. **Infrastruktura rrugore e komunës është shumë e vogël dhe zhvillimi i saj i vazhdueshëm do të duhej të jetë një nga qëllimet zhvillimore.**


Tabela nr. 7: Rrjeti lokal rrugor në km, sipas viteve

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	ndryshimi 2006-2014
Asfalt dhe gurë katror	71	73	73	73	74	78	83	99	105	34
Makadam	7	7	7	7	9	9	9	14	15	8
Tokësor	3	3	5	5	7	7	7	9	10	7
Të paprera	13	13	15	15	15	15	15	17	17	4
Gjithsej	94	96	100	100	105	109	114	139	147	53

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Në vitin 2014 ka filluar bashkëpunimi për sigurimin e kredisë prej Bankës Botërore, me të cilën planifikohet të meremetohet infrastruktura rrugore, me çka planifikohet të përfshihen 1.400 metra rrugë dhe 900 metra kanalizim atmosferik.

*Fotografia nr.*3. Lokacioni i rrugëve në hartë



Në raport me banesat e përfunduara mund të vërehet se në vitin 2007 është arritur maksimumi m 145 banesa të përfunduara ose të legalizuara me 9.574 m2 sipërfaqe të dobishme. Përndryshe mesatarisht në periudhën prej vitit 2005 deri 2013 janë ndërtuar ose legalizuar nga 59 banesa me 7.860 m2 sipërfaqe të dobishme.

Tabela nr. 8: Banesa të përfunduara dhe sipërfaqe të dobishme për banim, sipas viteve

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	mesatarja 2005-2013
Numri i banesave	92	65	145	26	41	41	47	35	36	59
Sipërfaqe të dobishme në m2	7,029	5,904	9,574	6,692	8,757	8,852	9,549	6,710	7,676	7,860

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

3.5 Bujqësia

Bujqësia paraqet një nga degët relevante në komunë. Në komunë në vitin 2014 ka pasur 3.503 hektarë sipërfaqe bujqësore, prej të cilave 3.288 hektarë është sipërfaqe e punueshme, do të thotë 94%, derisa të tjerat 215 hektarë janë kullosa. Pjesa më e madhe prej sipërfaqeve të punueshme janë ara të lëvrueshme dhe bahçe të cilat përfshijnë 3.003 hektarë, do të thotë 91% të sipërfaqeve të punueshme. Sipërfaqja e përgjithshme e punueshme në vitin 2014 në raport me vitin 2015 është rritur për 49 hektarë, arat e lëvrueshme dhe bahçet për 134 hektarë, kopshtet për 21 hektarë, derisa livadhet janë zvogëluar për 106 hektarë.

Tabela nr. 8: Sipërfaqet bujqësore sipas kategorive të përdorimit sipas NNJTS 2005 u NNJTS 2013 për vitin 2014 në hektarë, sipas viteve

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2005-14, ndryshimi
Sipërfaqja bujqësore	3,399	3,427	3,467	3,467	3,389	3,389	3,402	3,449	3,517	3,503	104
Gjithsej sipërfaqja e punueshme	3,239	3,252	3,252	3,252	3,252	3,252	3,252	3,234	3,302	3,288	49
Ara të punueshme dhe bahçe	2,869	3,027	3,017	3,017	2,983	2,991	2,991	2,989	3,057	3,003	134
Pemëtari	19	37	37	40	40	40	40	40	40	40	21
Vreshta	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0
Livadhe	350	187	197	194	228	220	220	204	204	244	-106
Kullosa	160	175	215	215	137	137	150	215	215	215	55

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Pjesa më e madhe e sipërfaqeve të mbjella prej 2.458 hektarë në vitin 2014 është me grurë dhe misër, me gjithsej 1.460 hektarë ose 60% të sipërfaqes së përgjithshme të mbjellave Prej kulturave tjera me përfaqësim më të madh janë patatja për 330 hektarë dhe sipërfaqja është rritur për 26 hektarë në raport me vitin 2006, pas çka vijon jonxha me 170 hektarë. Sipërfaqja r përgjithshme e mbjellë në raport me vitin 2006 nuk ka ndryshim relevant, derisa në raport me kulturat ka zvogëlim të sipërfaqes së mbjellë me qepë, tërshërë, domate, tërfili etj., ndërsa rritje ka e patatja, gruri dhe misri.

Tabela nr. 9: Sipërfaqet dhe prodhimet e të mbjellave, sipas NNJTS 2005 dhe NNJTS 2013 për vitin 2014, sipas viteve

		2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2006-2014
Grurë	Sipërfaqja e mbjellë në ha	724	752	751	772	762	760	695	751	730	6
	Gjith. prodh. në tonë	2,234	2,069	2,834	2,869	2,863	2,847	2,560	2,584	3,008	774
Thekër	Sipërfaqja e mbjellë në ha	40	52	41	40	41	43	42	40	52	12
	Gjith. prodh. në tonë	46	52	53	51	53	57	53	47	88	42
Elb	Sipërfaqja e mbjellë në ha	89	90	72	66	63	68	58	69	89	0
	Gjith. prodh. në tonë	106	93	92	80	80	89	73	87	134	28
Tërshërë	Sipërfaqja e mbjellë në ha	45	46	38	36	37	32	31	36	25	-20
	Gjith. prodh. në tonë	55	50	57	52	53	47	40	43	42	-13
Misër	Sipërfaqja e mbjellë në ha	718	727	717	719	726	725	783	750	730	12
	Gjith. prodh. në tonë	2,920	2,642	2,956	3,269	3,269	3,097	3,523	3,377	3,579	659
Patate	Sipërfaqja e mbjellë në ha	304	307	312	305	305	303	304	303	330	26
	Gjith. prodh. në tonë	6,636	5,866	6,767	6,222	6,532	6,413	6,384	6,328	6,837	201
Qepë	Sipërfaqja e mbjellë në ha	38	37	30	24	24	21	23	22	17	-21
	Gjith. prodh. në tonë	242	201	175	151	144	126	136	132	100	-142
Hudhër	Sipërfaqja e mbjellë në ha	5	4	4	3	3	3	4	4	8	3
	Gjith. prodh. në tonë	22	17	19	11	12	12	18	16	34	12
Lakër	Sipërfaqja e mbjellë në ha	38	39	42	47	47	47	49	52	39	1
	Gjith. prodh. në tonë	570	585	639	705	705	611	735	780	585	15
Domate	Sipërfaqja e mbjellë në ha	84	81	77	77	79	79	78	78	71	-13
	Gjith. prodh. në tonë	1,531	1,439	1,440	1,469	1,580	1,580	1,560	1,560	1,420	-111
Speca	Sipërfaqja e mbjellë në ha	74	73	72	75	74	72	70	69	70	-4
	Gjith. prodh. në tonë	1,477	1,264	1,397	1,462	1,554	1,434	1,400	1,380	1,400	-77
Kastravecë	Sipërfaqja e mbjellë në ha	18	18	19	16	14	13	13	13	9	-9
	Gjith. prodh. në tonë	372	286	374	272	224	221	208	208	142	-230
Shalqi	Sipërfaqja e mbjellë në ha	27	27	28	26	26	29	27	26	25	-2
	Gjith. prodh. në tonë	741	621	681	720	650	714	675	650	625	-116

Tërfil	Sipërfaqja e mbjellë në ha	119	130	102	99	101	102	103	106	107	-12
	Gjith. prodh. në tonë	675	658	572	541	505	525	515	530	560	-115
Jonxhe	Sipërfaqja e mbjellë në ha	174	162	193	192	184	177	175	165	170	-4
	Gjith. prodh. në tonë	1,130	926	1,156	1,126	1,196	1,145	1,138	990	1,047	-83
Groshëz	Sipërfaqja e mbjellë në ha	21	20	19	14	15	22	23	14	14	-7
	Gjith. prodh. në tonë	150	140	140	101	98	143	150	84	91	-59
GJTHSEJ	Sipërfaqja e mbjellë në ha	2,476	2,525	2,479	2,483	2,471	2,452	2,432	2,470	2,458	-18
	Gjith. prodh. në tonë	18,907	16,909	19,352	19,101	19,518	19,061	19,168	18,796	19,692	785

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Prodhimtaria e përgjithshme është rritur për 785 tonë dhe në vitin 2014 ka qenë 19.692 tonë, e cila para së gjithash ka të bëjë me prodhimtarinë e rritur të grurit, misrit dhe patates. Pothuaj në të gjitha kulturat tjera mund të vërehet prodhimtaria e zvogëluar. **Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, ndërsa duke i marrë parasysh politikat nacionale për rritjen e mbështetjes financiare në bujqësi paraqitet nevoja prej aktiviteteve plotësuese për përmirësim në këtë sektor.**

Numri i trungjeve të pemëve dhe prodhimtaria në tonë të pemëve në vitin 2014 nuk ka dallim relevant në raport me vitin 2014. Numri më i madh i trungjeve dhe prodhimtaria në tonë është te molla me 6.035 trungje dhe 91 tonë pemë. Krahas mollës në komunë më e përfaqësuar është edhe arra me prodhimtari prej 65 tonëve. Megjithatë në komunë prodhohen vetëm 252 tonë pemë dhe pemëtaria nuk paraqet degë të rëndësishme. **Duke pasur parasysh territorin e Komunës së Zhelinës ekzistojnë mundësi për forcimin e aktiviteteve për prodhimin e pemëve organike etj.**

Tabela nr. 10: Numri i trungjeve të pemëve dhe prodhimi i pemëve, sipas NNJTS 2013 për vitin 2014

Qershi	Numri i përgjithshëm i trungjeve		**1,480**		**10%**
	Gjithsej prodhimtari në tonë		22		9%
Vishnjë	Numri i përgjithshëm i trungjeve		1,350		9%
	Gjithsej prodhimtari në tonë		16		6%
Kajsi	Numri i përgjithshëm i trungjeve		395		3%
	Gjithsej prodhimtari në tonë	4		2%	
Ftoj	Numri i përgjithshëm i trungjeve		395		3%
	Gjithsej prodhimtari në tonë	6		2%	
Mollë	Numri i përgjithshëm i trungjeve		6,035		39%
	Gjithsej prodhimtari në tonë	91		36%	
Dardhë	Numri i përgjithshëm i trungjeve		1,485		10%
	Gjithsej prodhimtari në tonë	19		8%	
Kumbullë	Numri i përgjithshëm i trungjeve		2,350		15%

Pjeshkë	Gjithsej prodhimtari në tonë	28	11%	
	Numri i përgjithshëm i trungjeve	100		1%
Arra	Gjithsej prodhimtari në tonë	1	0%	
	Numri i përgjithshëm i trungjeve	1,855		12%
Gjithsej	Gjithsej prodhimtari në tonë	65	26%	
	Numri i përgjithshëm i trungjeve	15,445		100%
	Gjithsej prodhimtari në tonë	252	100%	

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

3.6 Arsimi

Në Komunën e Zhelinës ka **5 shkolla fillore** dhe ato janë: SHF "Ibrahim Temo" – Strimnicë, SHF "Luigj Gurakuqi" – Zhelinë, SHF "Pashko Vasa" – Grupçin, SHF "Fan Noli" – Trebosh dhe SHF "Hasan Tahsini" – Sedllarevë, ku mësojnë **3.072 nxënës.** Po ashtu ka edhe 12 shkolla periferike. **Numri i nxënësve dukshëm po zvogëlohet** dhe prej rreth 4.000 nxënës në vitin shkollor 2000/2001 është zvogëluar në rreth 3.000 persona, që paraqet zvogëlim prej 25%. Numri i arsimtarëve në shkollat fillore në vazhdimësi rritet dhe prej 202 mësimdhënësve në vitin shkollor 2000/2002 është rritur në 274 mësimdhënës në vitin shkollor 2013/2014. Me zvogëlimin e numrit të nxënësve dhe rritjen e numrit të mësimdhënësve është përmirësuar raporti prej 20 nxënës në një mësimdhënës në 11 nxënës në një mësimdhënës, që synon drejt përmirësimit afatgjatë të cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e ofertës së fuqisë punëtore.

Tabela nr. 11: Nxënës dhe mësimdhënës në shkollat fillore

Viti shkollor	Nxënës në shkollat fillore	Mësimdhënës në shkollat fillore	Raporti i mësimdhënësve/nxënësve
2000/01	3,977	202	20
2001/02	4,022	211	19
2002/03	3,915	227	17
2003/04	3,849	224	17
2004/05	3,751	224	17
2005/06	4,010	235	17
2006/07	3,949	234	17
2007/08	3,770	241	16
2008/09	3,619	246	15
2009/10	3,545	257	14
2010/11	3,278	275	12
2011/12	3,258	271	12
2012/13	3,149	271	12
2013/14	3,072	274	11

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

3.7 Papunësia

Në Komunën e Zhelinës ka **984 persona të papunë të cilët janë kërkues aktiv.** Duke pasur parasysh se në komunë jetojnë afër 27 mijë banorë dhe aktiviteti i vogël në tregun e punës të gruas shqiptare, papunësia mund të llogaritet se është afërsisht sa mesatarja

nacionale. Prej personave me arsim të përfunduar të mesëm profesional, të papunësuar janë 30 teknikë ekonomik, 24 teknikë konfeksioni, 22 shoferë të automjeteve të lehta, 14 motra medicinale dhe 10 teknikë kimik-teknologjik. Po ashtu, ka edhe 39 persona të papunësuar me gjimnaz të kryer. Në krahasim me personat e papunësuar me arsim sipëror ka 9 profesorë të mësimit klasor nga gjuha shqipe, 8 juristë të diplomuar, 7 ekonomistë të diplomuar, 4 historianë të diplomua (profesorë). 4 profesorë të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe 3 pedagogë.


Tabela nr. 12: Numri i të papunësuarve, kërkues aktiv të punës

Niveli i arsimimit	Numri i të papunësuarve
Pa shkollim fillor	53
Me shkollim fillor	580
Me shkollim të mesëm profesional	242
Me shkollim të mesëm, gjimnaz	39
Arsim sipëror	70
Gjithsej	984

Burimi: Llogaritje e autorit në baza të dhënave nga Agjencia për punësim e RM.

Struktura e personave të papunë tregon qartë se niveli i arsimimit është i rëndësishëm për pa punësimin dhe afër **dy të tretat e personave të papunë janë pa shkollim të kryer të mesëm, derisa vetëm 7% janë me arsim të lartë.** Po ashtu, aktivimi i tregut të punës së grave nga rajoni paraqet një nga barrierat me të cilat ballafaqohet komuna.

Grafiku nr. 4. Struktura e personave të papunësuar sipas arsimit në qershor të vitit 2014



Burimi: Llogaritje e autorit në baza të dhënave nga Agjencia për punësim e RM.

Përfundim:

Analiza e situatës tregon se edhe krahas përparimit të bërë në një pjesë të fushave për zhvillim të komunës, akoma ekzistojnë mundësi të mëdha dhe sfida në më shumë fusha siç janë: infrastruktura, sipërmarrësi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla, ambienti i biznesit dhe krijimi i vendeve të punës, zhvillimi i bujqësisë, hotelerisë dhe turizmit.

4. Analiza e rezultateve nga hulumtimi në terren në Komunën e Zhelinës

Analiza e hulumtimit në terren në Komunën e Zhelinës përbëhej prej identifikimit të palëve të prekura të brendshëm dhe të jashtëm dhe shfrytëzuesve të shërbimeve dhe përcaktimin e nevojave të tyre. Kjo analizë ka për qëllim t'i përcaktojë procedurat e komunikimit me palët e prekura të brendshme dhe të jashtme, t'i përcaktojë problemet dhe nevojat që të mund të përpunohen ato çështje dhe të gjendet zgjidhje përmes masave adekuate.

Rezultatet nga analiza e gjendjeve të brendshme/jashtme paraqesin bazë për të gjitha fazat tjera në planifikimin strategjik, por edhe bazë ose pikë nisjeje për zbatimin dhe vlerësimin e avancimit në zbatimin e planit strategjik dhe për azhurnimin e tij. Prandaj, të gjitha të dhënat dhe informatat e grumbulluara, vetë procesi i analizës dhe të gjitha gjetjet duhet të evidentohen dhe të ruhen hollësisht.

Për nevojat hulumtimit në terren u organizua fokus grup në Komunën e Zhelinës, ku morën pjesë përfaqësues të komunës (departamenti për zhvillim lokal ekonomik, urbanizëm), ndërmarrjeve publike, sektori afarist, sipërmarrës.

Sfidat vijuese u identifikuan nga ana e të pranishmëve:

- Mungesa nga kuadri profesional për nevojat e subjekteve afariste në komunë (kontrollues, teknikë makinerie etj.);
- Mungesa e kuadrit profesional për nevojat e institucioneve arsimore, që ka të bëjë me mungesën e financimit nga buxheti shtetëror;
- Mungesa e kushteve të volitshme për aplikimin për kredi;
- Vështirësi për depërtim në tregun maqedonas (më shpesh i ofrojnë prodhimet dhe shërbimet e veta në tregun e jashtëm, p.sh. Kosovë dhe Shqipëri);
- Probleme me pagesë të kërkesave;
- Kuadër për punë në bibliotekë (bibliotekist);
- Mungesë e kabineteve dhe laboratorëve për lëndë profesionale në shkolla;
- Mungesë e sallave për edukatë fizike në shkolla;
- Mungesë e shkollave të mesme;
- Mungesë e personave të punësuar në shkolla;
- Mungesë e automjeteve zjarrfikëse;
- Mungesë e automjeteve për larjen e rrugëve në komunë (parku i automjeteve për ndërmarrjen publike për ujësjellës);

Krahas këtyre mungesave pjesëmarrësit në fokus grupe përmendën edhe disa punë pozitive, si për shembull:

- Komunikimi i shkëlqyeshëm mes Komunës së Zhelinës dhe përfaqësuesve të sektorit afarist

- Komuna shpesh aplikon në thirrjet për mbështetje ekonomike prej IPARD dhe Bankës Botërore;

Në pajtim me diskutimin dhe sfidat e përcaktuara, rekomandimet që vijojnë u dhanë si përfundim nga diskutimi në grupin punues:

1. Komuna e Zhelinës të sigurojë dhe organizojë trajnim, ku njerëzit do të mund të informohen për shërbimet të cilat i ofron komuna ose shërbimet në nivel nacional nga ana e institucioneve shtetërore

2. Të sigurohet zgjidhje për plasman më të mirë në treg për prodhimet dhe shërbimet të cilat i ofrojnë firmat dhe kompanitë nga Komuna e Zhelinës;

3. Të zhvillohet sistem mes shkollave, fakulteteve dhe formave për ndarjen e kuadrit të nevojshëm profesional në Komunën e Zhelinës;

4. Të sigurohet hapësirë dhe kuadër profesional për hapjen e kopshtit dhe qëndrimit ditor për fëmijët në Komunën e Zhelinës;

5. Të sigurohet profesionist për punësim në bibliotekën ekzistuese në Komunën e Zhelinës;

6. Të caktohet tokë në Komunën e Zhelinës, e cila do të mund të ndahet për tu punuar për grupet në nevojë dhe familjet në Komunën e Zhelinës;

7. Të përgatitet sistem se si punëdhënësit dhe komuna të organizojnë trajnime për zhvillim të gjithë komunës me kontribut të përbashkët nga të gjitha palët e interesuara.

5. Vizioni, misioni dhe përparësitë e Komunës së Zhelinës

5.1 Vizioni

Vizioni i Komunës së Zhelinës është të rritet në qendër të rëndësishme ekonomike, me potencial të fuqishëm për zhvillim përmes bashkëpunimit të fuqishëm me punëdhënësit, të cilët do t'i rritin investimet dhe do të krijojnë vende pune.

5.2 Misioni


Misioni i Komunës së Zhelinës është të rritet në servis efikas për qytetarët dhe bizneset në komunë

5.3 Vlerat

Vlerat e Komunës së Zhelinës karakterizohen me afërsi të popullatës lokale, të kuptuarit e problemeve të tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve:

- Transparencë dhe përgjegjësi
- Profesionalizëm dhe shërbime cilësore
- Mikpritje dhe shërbim

5.4. Prioritetet për zhvillim të Komunës së Zhelinës



6. Qasja strategjike e Komunës së Zhelinës

Zhvillimi ekonomik lokal është bazë për maksimizimin e potencialit të shumë faktorëve zhvillimor duke përfshirë: lokacionin, infrastruktura, resurset njerëzore, kapitali dhe financat, mjetet dhe teknologjia, struktura industriale, kualiteti i jetës, klima investuese, kapaciteti institucional dhe bashkësia.

Dizajnimi dhe implementimi i Strategjisë do të jetë me rëndësi të veçantë për komunën, për nxitjen e perspektivës së saj për rritje dhe zhvillim ekonomik. Inovacionet, shkathtësitë, sipërmarrësia dhe kohezioni shoqëror janë shtytësit kryesor të zhvillimit. Mbi secilin nga këto shtytës, pushteti lokal ka ndikim të fuqishëm. Duke pasur parasysh ndikimin e bashkësisë lokale, nevojitet partneritet mes komunës, bizneseve dhe shoqërisë civile për aktivitete të koordinuara dhe politika të përshtatura për rrethanat lokale. Partneriteti është instrument i politikave lokale dhe potencialisht formë e re e organizimit mes sektorit publik dhe atij privat. Kjo ka ndikim të fuqishëm në drejtim të nxitjes së njësive të bashkësisë lokale drejt përmirësimit të efikasitetit të implementimit të shërbimeve të cilat i ofrojnë. Partneriteti ndërton rrjete lokale dhe paraqet themel për lidhje mes aktorëve shoqëror.

Ambienti i biznesit për ndërmarrjet miro, të vogla dhe të mesme në nivel lokal do të përmirësohet përmes inkurajimit për formalizmin e sipërmarrësve, të cilët do të trajnohen për sipërmarrësi dhe menaxhment, ndërtimin e zinxhirit të vlerës së shtuar, biznes shërbimeve dhe qasja deri te financat.

Vizioni i Komunës së Zhelinës është të rritet në qendër të rëndësishme ekonomike me potencial të fuqishëm për zhvillim, përmes bashkëpunimit të fuqishëm me punëdhënësit, të cilët do t'i rritin investimet dhe do të krijojnë vende pune. Për realizimin e vizionit, komuna do të rritet në servis efikas për qytetarët dhe bizneset.

Duke u ballafaquar me mjetet e pamjaftueshme financiare, komuna do të shfrytëzojë burime alternative të financimit për mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm. Rritja e mundësive për sigurimin e mjeteve plotësuese financiare do të fillojë përmes forcimit të kapaciteteve dhe shkathtësive në bashkësinë lokale dhe partnerët për planifikim, implementim dhe administrim të projekteve/programeve.


Qëllimet kryesore strategjike për zhvillim të mëtejshëm të bashkësisë lokale do të sigurojnë kornizë për implementimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve, përmes të cilave do të implementohet Strategjia për zhvillim ekonomik lokal. Aktivitetet janë të lidhura mes tyre dhe duhet të shihet si një tërësi.

Duke i pasur parasysh analizat dhe diskutimet e zbatuara, fushat relevante strategjike të cilat paraqesin bazë për zhvillimin ekonomik lokal janë infrastruktura, zhvillimi socio-ekonomik dhe zhvillimi i resurseve njerëzore.

6.1 Qëllimet strategjike

Implementimi i Strategjisë për zhvillim lokal të Komunës së Zhelinës për periudhën 2016-2020 përfshinë realizimin e 4 qëllimeve strategjike, të cilat përbëhen prej më shumë aktiviteteve në fushat e veprimit:

Grafiku nr. 5. Qëllimet strategjike për zhvillim lokal të Komunës së Zhelinës



6.1.1 Qëllimi strategjik 1: Zhvillimi i infrastrukturës në komunë

Prioriteti 1: Infrastrukturë më e mirë për biznesin dhe banorët e komunës përmes investimeve kapitale

Komuna e Zhelinës ka për përcaktim që të rritet në komunë me të gjitha shenjat në pjesën e infrastrukturës dhe urbanizimit. Në të njëjtën kohë ky përcaktim paraqet imperativ dhe sfidë për pushtetin lokal që ta plotësojë në periudhën e ardhshme me cilësi më të lartë. Sot pushteti lokal angazhohet për urbanizim më të madh të gjitha pjesëve në territorin e komunës, për shkak të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe stimulimin e zhvillimit ekonomik.

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe fekal në të gjitha pjesët e komunës është imperativ për zhvillimin lokal, veçanërisht për vendbanimet pa rrjet të tërësishëm të kanalizimit. Rikonstruimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në cilësinë e jetës dhe nevojat për zhvillimin e ekonomisë. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore është fokusuar drejt mundësimit të kushteve për transport të sektorit ekonomik dhe lëvizjes më të shpejt të popullatës për nevojat ditore në dhe prej vendbanimeve. Urbanizimi i hapësirës kërkon fokusim drejt ndërtimeve pa leje dhe asfaltimit të rrjetit rrugor ku është kjo e nevojshme.

Aktiviteti 1.1: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale dhe rrugicave, dhe ndërtimit të trotuareve.

Përshkrimi i aktivitetit: Infrastruktura rrugore është bazë për zhvillimin e ekonomisë dhe në periudhën e ardhshme do të ndërtohen 3 rrugë të reja në vendbanimet Zhelinë, Trebosh dhe Çiflik dhe do të mbyllen gropat me asfalt dhe do të bëhen trotuare dhe rrugica me bekaton me sipërfaqe prej 4.000 m2.

Rezultati: Tre rrugë të rekonstruara në Zhelinë, Trebosh dhe Çiflik, mbyllja e gripave me asfalt dhe bekaton etj. e sipërfaqe prej 4.000 m2.

Aktiviteti 1.2: Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit përmes ndërtimit të rrjetit dhe përmirësimi i kanalizimit atmosferik.

Përshkrimi i aktivitetit: Rrjeti i ujësjellësit dhe komunal i siguron kushtet themelore për jetë dhe do të ndërtohet stacion për pompa për furnizimin regjional me ujë për 13 vendbanime, dhe gypa për bartjen e ujit deri te rezervuari me kapacitet prej 2.000 m3. Po ashtu, do të vendosen gypa për furnizimin me ujë deri te lidhja në f. Pllasnicë, me sistemin ekzistues për furnizim me ujë, prej ku do të furnizohen me ujë f. Pllasnicë, Trebosh dhe Ozormishtë.

Rezultati: Stacioni i ndërtuar për pompa për furnizimin regjional me ujë për 13 vendbanime, gypat e vendosura për bartjen e ujit deri te rezervuari prej 2.000 m3, gypi i vendosur për furnizimin me ujë deri te lidhja në f. Pllasnicë.

Aktiviteti 1.3: Planifikimi urbanistik dhe hapësinor për zhvillim ekonomik përmes miratimit të planeve urbanistike dhe legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje

Përshkrimi i aktivitetit: Në periudhën e ardhshme planifikohet përgatitja e dy dokumentacioneve më të mëdha teknike për furnizimin regjional me ujë dhe atë për kanalizim dhe vazhdimin e sistemit. Në furnizimin me ujë regjional prej rezervuarit të përbashkët për 8 vendbanime prej regjionit të Dërvenit dhe përpunimi i dokumentacionit teknik për sistem regjional për ujë prej Malit Sharr.

Rezultati: Numri i objekteve të legalizuara dhe sipërfaqja e tyre, plani i miratuar urbanistik, dokumentacioni teknik për kanalizim dhe vazhdimi i sistemit të furnizimit regjional me ujë nga rezervuari i përbashkët për 8 vendbanime prej regjionit të Dërvenit, dokumentacioni i përpunuar teknik për sistemin regjional për ujë prej Malit Sharr.

Aktiviteti 1.4: Hapja dhe rregullimi i zonave për rekreacion, siç janë fushat për lojë për fëmijë, sheshet, parqet, fushat sportive dhe shkollat.

Përshkrimi i aktivitetit: Me këtë aktivitet do të rritet oferta turistike në komunë, ashtu që krahas objekteve të zhvilluara hotelerie do të ndërtohen fusha për lojë për fëmijët, shesh ose park dhe fushë sportive, me çka në një vend do të mund të shfrytëzohen më shumë shërbime dhe turistët do të mund të qëndrojnë më gjatë. Ky aktivitet do të realizohet si partneritet publik-privat me ndërmarrjet në këtë fushë.

Po ashtu, në plan është renovimi i fushës sportive në f. Debërc. Në bashkëpunim me MASH planifikohet edhe rekonstruimi i shkollës “Pashko Vasa”. Në komunë do të përmirësohet edhe infrastruktura lidhur me qendrat e rekreacionit, shëtitoret etj.

Rezultati: Fushë e ndërtuar për lojë për fëmijë, park ose shesh i ndërtuar, fushë rekreacioni e ndërtuar, fushë sportive e rinovuar në f. Debërc, shkolla e rekonstruar “Pashko Vasa”.

6.1.2 Qëllimi specifik 2: Zhvillimi socio-ekonomik i popullatës

Prioriteti 2: Zhvillimi i ekonomisë përmes mbështetjes së bizneseve të reja, zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, bujqësisë dhe turizmit.

Rritja e nivelit të zhvillimit ekonomik mund të arrihet përmes nxitjes dhe zhvillimit të sektorit të biznesit dhe industrive bartëse në komunë. Bashkëpunimi me partnerët do të vendoset përmes krijimit të grupit punues adekuat për mbështetje të ZHEL. Përmes përgatitjes dhe krijimit të kushteve adekuate infrastrukturore në komunë dhe përmes investimit në resurset njerëzore, të cilat do të disponojnë me njohuri dhe shkathtësi adekuate të përshtatura sipas nevojave të tregut, di të ndikojnë mbi tërheqjen e investimeve nga vendi dhe jashtë. Investimet e reja gjithmonë janë sfidë për ndërmarrësit, por edhe për institucionet e sistemit që janë përgjegjës për zhvillimin ekonomik.

Qëllimet do të arrihen përmes forcimit të koordinimit mes institucioneve relevante në nivel nacional, regjional dhe lokal, i rëndësishëm për nxitjen e investimeve dhe shfrytëzimit të mjeteve nga fondet e BE për bashkëpunim ndërkufitar dhe promovimin e partneritetit publik-privat për nxitjen e investimeve. Me stabilitetin financiar që e ka komuna, tashmë janë ndërmarrë masa konkrete për financimin e projekteve kapitale komunale. Kuptohet se në plan të parë gjithmonë është grumbullimi i mjeteve financiare nga burimet personale, siç janë tatimet në pronë, taksat, por edhe bllok dotacionet nga pushteti qendror dhe të ardhurat nga toka ndërtimore. Megjithatë, për planet ambicioze afatgjate të komunës, nevojiten edhe burime plotësuese dhe alternative për financim, siç janë huazimet, partneriteti publik-privat, fondet evropiane para aderimit, si dhe donacione dhe sponsorizime tjera. Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të gjithë kësaj fushe, udhëheqësia komunale i jep prioritet të lartë mundësive për financim komunal.

Ekzistimi i autostradës në komunë jep bazë të mirë për zhvillimin e turizmit të suksesshëm, i cili synon drejt tërheqjes së vizitorëve që të ndalen, të qëndrojnë dhe ta konsumojnë ofertën turistike. Qëllimet do të realizohen përmes rritjes së shërbimeve të cilat i ofron sektori privat dhe i njëjti do të implementohet përmes partneritetit publik-privat. Inovacioni dhe aftësia konkurruese e ekonomisë ka rëndësi të veçantë, pasi që ky është parakusht themelor afarist që të mundësojnë rritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik të Komunës.

Po ashtu, kushtet e volitshme klimatike të cilat janë të mira për të gjitha llojet e prodhimtarisë bujqësore, si dhe vend pozita e volitshme në rajon, sigurojnë kushte për zhvillim të bujqësisë.

Aktiviteti 2.1: Tërheqja e investimeve nga vendi dhe jashtë

Përshkrimi i aktivitetit: Me këtë aktivitet do të mundësohet informimi më i mirë i investuesve të mundshëm përmes materialit promovues dhe ueb faqes së përmirësuar. Kështu, investuesit do të mund t'i marrin informatat e nevojshme për komunën, të cilat janë relevante për investuesin. Përfaqësuesit e komunës do të mund t'i gjejnë investuesit e mundshëm dhe do t'i prezantojnë kushtet e volitshme për investime. Këshilli i Komunës do ta shqyrtojë edhe mundësinë për lirime tatimore për investuesit, me qëllim të rritjes së atraktivitetit për investime në komunë.

Rezultati: Material i përgatitur promovues, numri i takimeve të mbajtura me investuesit potencial, ueb faqja e zhvilluar dhe numri i lirimeve tatimore për investuesit.

Aktiviteti 2.2: Zhvillimi i turizmit tranzitues përmes hapjes së veprimtarive shërbyese dhe rekreative në rajonet afër autostradës.

Përshkrimi i aktivitetit: Ky aktivitet është i lidhur me aktivitetin 1.4.

Rezultati: Rritja e numrit të vizitorëve.

Aktiviteti 2.3: Zhvillimi i bujqësisë përmes trajnimeve për fondet IPARD.

Përshkrimi i aktivitetit: Duke marrë parasysh nevojën nga përmirësime në bujqësi, do të bëhet analizë e nevojave për trajnime për bujqit në komunë. Në bazë të analizës, do të realizohen trajnime për shfrytëzimin e fondeve. Trajnimet do të realizohen në komunë.

Rezultati: Analiza e nevojave për trajnime, numri i trajnimeve dhe numri të trajnuarve.

Aktiviteti 2.4: Zhvillimi i sipërmarrësisë ermes trajnimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zhvillimi i rrjetit sipërmarrës dhe informimi për shërbimet të cilat ofrohen për ndërmarrësit.

Përshkrimi i aktivitetit: Pjesa më e madhe e biznes bashkësisë e paraqesin NVM, dhe të njëjtat kanë nevojë për trajnime dhe shërbime nga pushteti lokal. Për implementimin e këtij aktiviteti do të realizohen trajnime në pajtim me kërkesat e punëdhënësve. Po ashtu, do të organizohen takime me qëllim të shkëmbimit të përvojave gjatë punës dhe do t'u jepet mbështetje ndërmarrjeve përmes informimit për atë se ku mund të gjenden shërbimet për të cilat kanë nevojë.

Rezultati: Analiza e tipit dhe përmbajtjes së trajnimeve të nevojshme (p.sh. plasmani i prodhimeve, përgatitja e dokumentacionit të tenderit, analiza e tregut, qasja deri te financat etj.), numri i trajnimeve dhe numri i të trajnuarve, takimet e organizuara me ndërmarrësit prej komunës, ndërmarrësit e shërbyer me informata për shërbimet e nevojshme.

Aktiviteti 2.5: Zhvillimi i bashkëpunimit mes sektorit privat dhe komunës

Përshkrimi i aktivitetit: Bashkëpunimi mes sektorit privat dhe komunës do të zhvillohet në suaza të grupit punues të ri të krijuar enkas për këtë, ku do të marrin pjesë punëdhënësit më të mëdhenj prej komunës, me qëllim të dhënies së propozimeve për zhvillimin ekonomik (p.sh. partneritete publike-private, biznes ambienti, punësimi i të rinjve, vëzhgimi i aktiviteteve nga Strategjia për zhvillim ekonomik lokal etj.). Grupi punues do të takohet së paku një herë në tre muaj. Mbledhjet, rendi i ditës dhe procesverbalet do t'i koordinojë komuna. Propozimet do të shqyrtohen në Këshillin e Komunës.

Rezultati: Grupi i punës i krijuar, numri i iniciativave të parashtruara deri te Këshilli i Komunës, numri i iniciativave të pranuara.

Aktiviteti 2.6 Rritja e qëndrueshmërisë financiare të komunës

Përshkrimi i aktivitetit: Me zhvillimin e përgjithshëm të komunës vazhdimisht duhet të rriten mjetet prej tatimeve, transferimeve prej Buxhetit të RM, prej fondeve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe burimeve tjera të financimit. Ky aktivitet është i lidhur me aktivitetet tjera 1.4, 2.1, 2.2 dhe 3.4.

Rezultati: Mjetet financiare prej burimeve personale, numri i partneriteteve publike-private, mjeteve financiare, mjeteve të siguruara përmes projekteve prej burimeve tjera.

6.1.3 Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi i shkathtësive njerëzore

Prioriteti 3: Përmirësimi i shkathtësive të resurseve njerëzore përmes arsimit dhe punësimit.

Lista prioritare e drejtimeve strategjike zhvillimore e Komunës së Zhelinës, e përbëjnë edhe zhvillimi dhe shfrytëzimi i potencialit njerëzor dhe shkathtësitë. Kapitali njerëzor, ku janë përqendruar dituria, aftësitë dhe me këtë edhe fuqia që të krijohen vlera të reja, marrin vend të rëndësishëm në zhvillimin e çdo komune dhe regjioni.

Komuna e Zhelinës ka nevojë nga zhvillimi dhe shfrytëzimi i potencialit të faktorit njerëzor, i cili është shtyllë për zhvillimin e drejtimeve tjera strategjike. Për realizimin e qëllimeve në këtë plan nevojitet forcimi i kapaciteteve, si në departamentet për zhvillim ekonomik lokal, ashtu edhe te banorët e papunësuar në komunë.

Kërkesa e elementeve specifike të tregut të punës është në varësi të drejtpërdrejtë nga zhvillimi dhe dinamika e ndryshimeve në botën afariste, ndryshimet në sferën socio-ekonomike ose thënë shkurt, prej kërkesave të tregut të mirave drejt të cilave synojnë subjektet afariste shpejt të përshtaten dhe t'u përgjigjen atyre kërkesave. Sistemi arsimor nuk karakterizohet me fleksibilitet dhe prandaj vjen deri te përputhja mes ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore.

Një nga barrierat kryesore gjatë punësimit të rinjve është përvoja e punës dhe shkathtësitë. Përmirësimi i kësaj fushe mund të arrihet vetëm me realizimin e programeve të bashkëpunimit mes të papunësuarve, bashkësisë lokale dhe sektorit afarist. Analiza e nivelit arsimor të papunësuarve tregon se pjesa e fuqisë së paangazhuar punëtore është më e madhe te personat pa arsim, dhe zvogëlohet me rritjen e nivelit arsimor. Si edhe te komunat tjera, ashtu edhe në Zhelinë, aktiviteti ekonomik është proporcionale me shkallën e arsimit të popullatës dhe më e vogël te personat pa arsim dhe me nivel të ulët të arsimit, ndërsa më e madhe te ata me fakultet.

Aktiviteti 3.1: Ulja e papunësisë dhe përmirësimi i transferimit prej shkollës në punë

Përshkrimi i aktivitetit: Ky aktivitet do të realizohet përmes informimit të rinjve dhe punëdhënësve prej komunës, që ta shfrytëzojnë masën puna praktike, të cilën e implementon Qendra për punësim në Tetovë. Me këtë masë të rinjtë do të shkojnë te punëdhënësit që t'i përmirësojnë shkathtësitë gjatë punës, për çka do të marrin 6.200 denarë në muaj me tatim personal në të ardhurat të kalkuluar dhe sigurim në rast të lëndimit gjatë punës, në afat prej 4 muajve. Po ashtu, të papunësuarit do të informohen për mundësitë për trajnim pa pagesë për gjuhë të huaja, puna me kompjuterë dhe sipërmarrësi.

Rezultati: Numri i praktikantëve të papunësuar; numri i personave të trajnuar për shkathtësi për TI, gjuhë të huaja dhe sipërmarrësi.

Aktiviteti 3.2: Përmirësimi dhe modernizimi i procesit edukativo arsimor

Përshkrimi i aktivitetit: Aktiviteti do të realizohet përmes mbështetjes së shkollave nga ana e punëdhënësve me përgjegjësi shoqërore në komunë, me sigurimin e mjeteve për punë në orë, si material reprezentativ. Komuna në bashkëpunim me shkollën do të sigurojë bibliotekist, i cili do të ketë obligim që t'i njoftojë të rinjtë dhe prindërit e tyre me gjendjen në tregun e punës dhe t'i informojë dhe t'i orientojë nxënësit në shkollat e mesme, pas përfundimit të cilit do të kenë më shumë mundësi për punësim dhe avancim në karrierë.

Rezultati: Mjete të siguruara për punë në orë nga punëdhënësit lokal, biblioteka e hapur, fëmijë dhe prindër të informuar për arsimin e mëtejshëm dhe mundësitë për punësim në tregun e punës.

Aktiviteti 3.3: Zhvillimi i strukturave të administratës për mbështetje të zhvillimit ekonomik

Përshkrimi i aktivitetit: Personat nga DZHEL në mënyrë të vazhdueshme duhet t'i ndjekin aktivitetet e Strategjisë, të përgatisin raporte, si dhe revizion, për çka nevojitet të trajnohen për planifikim, implementim, monitorim dhe evaluim të programeve dhe masave. Po ashtu, do të duhet të marrin pjesë në trajnime dhe seminare për vëzhgimin e aktiviteteve vijuese në komuna tjera dhe praktikat e mira.

Rezultati: Vëzhgimi i vazhdueshëm dhe raportimi për aktivitetet, pjesëmarrja në trajnime/seminare për zhvillim ekonomik lokal.

Aktiviteti 3.4: Forcimi i kapaciteteve të strukturave të administratës për pjesëmarrje në projekteve të financuara nga BE dhe donatorë tjerë

Përshkrimi i aktivitetit: Për shfrytëzimin e mundësive prej fondeve të BE dhe donatorëve tjerë do të punësohet person në komunë, me njohje të mirë të gjuhës angleze, i cili do të trajnohet për aplikim, implementim dhe administrim të projekteve. Ky aktivitet mund të realizohet edhe përmes punësimit të personit, i cili tashmë ka njohuri dhe shkathtësi për shfrytëzimin e fondeve, ose angazhimin e konsulentit të jashtëm.

Rezultati: Person i punësuar/i trajnuar, numri i projekteve të aplikuara për financim nga BE, numri i projekteve të fituara, numri i projekteve dhe buxheti i projekteve të realizuara.

6.1.4 Qëllimi strategjik 4: Zhvillimi i efikasitetit energjetik

Prioriteti 4: Zhvillimi i qëndrueshëm përmes përmirësimit të efikasitetit energjetik

Efikasiteti energjetik është një nga mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm të komunës. Do të zhvillohen dhe implementohen masa për efikasitet energjetik, zbatimi i të cilit do të kontribuojë për zvogëlimin e shpenzimit përfundimtar të energjisë, si dhe masat nga aspekti i prodhimtarisë, transferimit dhe distribuimit të energjisë, të cilat po ashtu do të duhej të kontribuojnë për kursime të dukshme në shpenzimin e energjisë primare. Komuna do të synojë drejt përmirësimit të efikasitetit energjetik, zhvillimin e burimeve alternative të energjisë etj. Me implementimin e aktiviteteve nga ky qëllim specifik do të zvogëlohet shpenzimi i energjisë elektrike dhe do të kursehet. Po ashtu, prodhimtaria e energjisë elektrike nga mbeturinat sekondare në bujqësi paraqet mundësi për krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe përmirësimin e ambientit.

Aktiviteti 4.1: Kursimi energjetik përmes ndriçimit rrugor komunal

Përshkrimi i aktivitetit: Projekti për përmirësimin e efikasitetit energjetik do ta përmirësojë ekonomizimin, ndërsa kursimet do të jenë të dukshme menjëherë dhe lehtë do të mund të demonstrohen dhe të vërtetohen. Aktiviteti kryesor do të jetë zëvendësimi i llambave të zhivës me llamba natriumi. Njëkohësisht do të implementohen edhe llambat LED, varësisht nga arsyetimi ekonomik.

Rezultati: Ndriçimi i zëvendësuar ekzistues rrugor, sasi më e vogël e energjisë së shpenzuar dhe emetim më i vogël i dyoksid karbonit në atmosferë.

Aktiviteti 4.2: Aplikimi i rritur dhe më efikas i biomasës

Përshkrimi i aktivitetit: Aktiviteti që do të realizohet përmes shqyrtimit dhe shfrytëzimit të mundësive për rritjen e shfrytëzimit të biomasës. Bashkëpunimi me punëdhënësit për investime të mundshme si dhe ambienti i mirë do të vendosen nga ana e komunës.

Rezultati: Aplikimi i rritur i biomasës, aplikimi më efikas i biomasës

Aktiviteti 4.3: Përdorimi i energjisë dhe potenciali për efikasitet energjetik në ndërtesat publike

Përshkrimi i aktivitetit: Me këtë aktivitet do të zvogëlohet shpenzimi i energjisë dhe shpenzimet vjetore për energji. Aktiviteti do të realizohet përmes renovimit të fasadave, zëvendësimit të dritareve, montimit të ngrohjes qendrore inovative etj.

Rezultati: Shpenzimi i zvogëluar i energjisë në ndërtesat publike etj.

Tabela nr.13 Pasqyrë e aktiviteteve të planifikuara sipas qëllimeve strategjike

Prioriteti	Qëllimi strategjik	Aktiviteti
Infrastrukturë më e mirë për biznesin dhe banorët e komunës përmes investimeve kapitale	Zhvillimi i infrastrukturës në komunë	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale dhe rrugicave, dhe ndërtimit të trotuareve.
		Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit përmes ndërtimit të rrjetit dhe përmirësimi i kanalizimit atmosferik.
		Planifikimi urbanistik dhe hapësinor për zhvillim ekonomik
		Hapja dhe rregullimi i zonave për rekreacion, siç janë fushat për lojë për fëmijë, sheshet, parqet, fushat sportive.
Zhvillimi i ekonomisë përmes mbështetjes së bizneseve të reja, zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, bujqësisë dhe turizmit	Zhvillimi socio-ekonomik i popullatës	Tërheqja e investimeve nga vendi dhe jashtë
		Zhvillimi i turizmit tranzitues përmes hapjes së veprimtarive shërbyese dhe rekreative në rajonet afër autostradës.
		Zhvillimi i bujqësisë përmes trajnimeve për fondet IPARD
		Zhvillimi i sipërmarrësisë ermes trajnimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zhvillimi i rrjetit sipërmarrës dhe informimi për shërbimet të cilat ofrohen për ndërmarrësit.
		Zhvillimi i bashkëpunimit mes sektorit privat dhe komunës
		Rritja e qëndrueshmërisë financiare të komunës
Përmirësimi i shkathtësive të resurseve njerëzore përmes arsimit dhe punësimit	Zhvillimi i shkathtësive njerëzore	Ulja e papunësisë dhe përmirësimi i transferimit prej shkollës në punë
		Përmirësimi dhe modernizimi i procesit edukativo arsimor
		Zhvillimi i strukturave të administratës për

		mbështetje të zhvillimit ekonomik
		Forcimi i kapaciteteve të strukturave të administratës për pjesëmarrje në projekteve të financuara nga BE dhe donatorë tjerë
Zhvillimi i qëndrueshëm përmes përmirësimit të efikasitetit energjetik	Zhvillimi i efikasitetit energjetik	Kursimi energjetik përmes ndriçimit rrugor komunal
		Aplikimi i rritur dhe më efikas i biomasës
		Përdorimi i energjisë dhe potenciali për efikasitet energjetik në ndërtesat publike

Shtojca 1. PLANI AKSIONAR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Qëllimi strategjik 1. Zhvillimi i infrastrukturës në komunë						
N. R.	Aktiviteti	Rezultati	Burimi i verifikimit	Përgjegjës	Periudha	Buxheti (EUR)
1.1	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale dhe rrugicave, dhe ndërtimit të trotuareve.	• ndërtimi i tre rrugëve të reja • rrugë ekzistuese të rinovuar me sipërfaqe prej rreth 4.000м2. • trotuare të ndërtuara • trotuare të rinovuar	NJVL	NJVL MASH MF	2016-2020	871.473 76.000
1.2	Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit përmes ndërtimit të rrjetit dhe përmirësimi i kanalizimit atmosferik.	• rrjeti i ri i ndërtuar komunal • rinovimi i rrjetit ekzistues komunal • ndërtimi i kanalizimit atmosferik • rinovimi i kanalizimit atmosferik • stacioni i pompave i ndërtuar për furnizim me ujë rajonal për 13 vendbanime • gypa për bartjen e ujit deri te rezervuari prej 2.000 m3 • gypa të vendosur për furnizim me ujë deri te lidhja në f. Pllasnicë	NJVL	NJVL	2016-2020	200.000
1.3	Planifikimi urbanistik dhe hapësinor për zhvillim ekonomik	• numri i objekteve të legalizuara • sipërfaqja e objekteve të legalizuara • plani i miratuar urbanistik • dokumentacioni teknik për kanalizim dhe vazhdimi i sistemit për furnizim me ujë rajonal prej rezervuarit të përbashkët për 8 vendbanime në rajonin e Dërvenit • dokumentacion i përgatitur teknik	NJVL	NJVL SHMMP QZHRPP	2016-2020	103.511 117.000

		për sistemin rajonal për ujë nga Mali Sharr.				
1.4	Hapja dhe rregullimi i zonave për rekreacion, siç janë fushat për lojë për fëmijë, sheshet, parqet, fushat sportive.	• fushë e ndërtuar për lojë për fëmijët • park dhe/ose shesh i ndërtuar • fushë rekreacioni e ndërtuar • fushë sporti e rinovuar në f. Debarcë • shkolla e rikonstruar "Pashko Vasa" • qendër sportive rekreacioni • shëtitore	NJVL, ZHEL, Punëdhënësit	NJVL, Punëdhën. MASH	2016-2020	30.000 100.000
Qëllimi strategjik 2: Zhvillimi socio-ekonomik i popullatës						
N. R.	Aktiviteti	Rezultati	Burimi i verifikimit	Përgjegjës	Periudha	Buxheti (EUR)
2.1	Tërheqja e investimeve nga vendi dhe jashtë	• materiali i përgatitur promovues • numri i takimeve të mbajtura me investuesit potencial • ueb faqja e zhvilluar • lirime tatimore për investuesit	NJVL, ZHEL, Punëdhënësit	NJVL, ZHEL, Këshilli i Komunës	2016-2020	Prej 4.000 deri 8.000
2.2	Zhvillimi i turizmit tranzitues përmes hapjes së veprimtarive shërbyese dhe rekreative në rajonet afër autostradës.	• Numri i turistëve	Punëdhënësit	NJVL, ZHEL	2016-2020	/
2.3	Zhvillimi i bujqësisë përmes trajnimeve për fondet IPARD	• analiza e nevojave për trajnime • numri i trajnimeve • numri i të trajnuarve	NJVL, ZHEL	NJVL, ZHEL	2016-2020	Prej 2.000 deri 4.000
2.4	Zhvillimi i sipërmarrësisë ermes trajnimeve për ndërmarrjet e vogla	• analiza e llojit dhe përmbajtjes së trajnimeve	NJVL, ZHEL, Punëdhënësit	NJVL, ZHEL	2016-2020	Prej 10.000

	dhe të mesme, zhvillimi i rrjetit sipërmarrës dhe informimi për shërbimet të cilat ofrohen për ndërmarrësit.	• numri i trajnimeve • numri i të trajnuarve • numri i takimeve/forumeve të organizuara me ndërmarrësit				deri 20.000
2.5	Zhvillimi i bashkëpunimit mes sektorit privat dhe komunës	• KESL i krijuar • numri i iniciativave të parashtruara prej KESL • numri i iniciativave të miratuara deri te këshilli i Komunës	NJVL, ZHEL, Këshilli i Komunës	NJVL, ZHEL, Punëdhënësit	2016-2020	/
2.6	Rritja e qëndrueshmërisë financiare të komunës	• mjete të rritura nga burimet personale • mjete të rritura nga burimet tjera • numri i partneriteteve publike private	NJVL, ZHEL	NJVL, ZHEL	2016-2020	/
Qëllimi strategjik 3. Zhvillimi i shkathtësive njerëzore						
N. R.	Aktiviteti	Rezultati	Burimi i verifikimit	Përgjegjës	Periudha	Buxheti (EUR)
3.1	Ulja e papunësisë dhe përmirësimi i transferimit prej shkollës në punë	• numri i praktikantëve të papunësuar në masën • numri i personave të trajnuar për shkathtësi të TI • numri i personave të trajnuar për gjuhë të huaja • numri i personave të trajnuar për sipërmarrësi	Qendra për punësim në Tetovë, punëdhënësit	NJVL, ZHEL, Punëdhë.	2016-2020	/
3.2	Përmirësimi dhe modernizimi i procesit edukativo arsimor	• mjete të siguruara për punë në orë • një person i punësuar dhe i trajnuar, bibliotekist dhe këshilltar për tregun e punës (kjo është e lidhur me aktivitetin 3.1) • biblioteka e hapur • numri i fëmijëve dhe prindërve të informuar për arsimin e	NJVL, ZHEL, shkollat fillore	NJVL, Punëdhënësit, ZHEL, shkollat	2016-2020	/

		mëtejshëm dhe mundësitë për punësim në tregun e punës				
3.3	Zhvillimi i strukturave të administratës për mbështetje të zhvillimit ekonomik	• raporte vjetore për implementimin e strategjisë • revizioni i Strategjisë në vitin 2017 • numri i trajnimeve/seminareve për zhvillim ekonomik lokal	NJVL, ZHEL	NJVL, ZHEL	2016-2020	1.000
3.4	Forcimi i kapaciteteve të strukturave të administratës për pjesëmarrje në projekteve të financuara nga BE dhe donatorë tjerë	• person i punësuar dhe i trajnuar për shfrytëzimin e burimeve tjera të financimit • numri i aplikacioneve në shpallje/tenderë publik • numri i projekteve të fituara • numri i projekteve të implementuara	NJVL, ZHEL	NJVL, ZHEL	2016-2020	/
Qëllimi strategjik 4. Zhvillimi i efikasitetit energjetik						
N. R.	Aktiviteti	Rezultati	Burimi i verifikimit	Përgjegjës	Periudha	Buxheti (EUR)
4.1	Kursimi energjetik përmes ndriçimit rrugor komunal	• ndriçimi ekzistues rrugor i zëvendësuar • sasi më e vogël e energjisë së shpenzuar • emetim më i vogël i dyoksid karbonit në atmosferë	NJVL	NJVL	2016-2020	/
4.2	Aplikimi i rritur dhe më efikas i biomasës	• aplikimi i rritur i biomasës • aplikimi më efikas i biomasës	NJVL, Punëdhënësit	NJVL	2016-2020	/
4.3	Përdorimi i energjisë dhe potenciali për efikasitet energjetik në ndërtesat publike	• shpenzimi i zvogëluar i energjisë në ndërtesat publike • aktivitete tjera për përmirësimin e efikasitetit energjetik, siç janë fasadat, dritaret, si dhe burime tjera të ngrohjes etj.	NJVL	NJVL	2016-2020	/

Shtojca 2. EKIPI PËR PËRGATITJEN E STRATEGJISË SË KOMUNËS SË ZHELINËS

Goran Velevski

Arben Halili

Gligor Mihaillovski